



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 583 Prot.

Tiranë, më 02/04/ 2021

V E N D I M

Nr. 56, Datë 02 / 04 / 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.162 regj, datë 30.12.2020, të paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë², Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare³ dhe Postës Shqiptare sh.a, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Shoqata “Shpresë për të Verbërit” është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019. Objekti i veprimtarisë së shoqatës është mbrojtja e interesave të anëtarëve të saj të verbër, mbrojtja e të drejtave të të verbërve në mënyrë të organizuar dhe publike, rritja e nivelit arsimor të tyre, integrimi në shoqëri si dhe përmirësimi i nivelit të tyre të jetesës. Gjatë punës në ndihmë të anëtarëve të verbër, shoqata është ndeshur në disa padrejtësi nga disa institucione shtetërore. Një ndër këto padrejtësi, e cila jo vetëm po u vështirëson edhe më tepër punën, por po i diferencon nga të tjerët, është si më poshtë:

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën MIE

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën AKEP

Institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor të hartojnë politikat dhe miratojnë akte ligjore në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihen edhe të verbërit. Këto akte duhet të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithmonë duke respektuar të drejtat e njeriut si dhe parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në vitin 2015, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, ka nxjerrë udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”. Ky udhëzim ka dalë në mbështetje të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se : “4. Ofrimi i shërbimeve për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër, që përjashtohen nga pagesa e tarifave postare, përcaktohet me udhëzim të ministrit, në përputhje me aktet e ratifikuara të Bashkimit Postar të Përbotshëm.” Kjo pikë jep vetëm të drejtën ligjore ministrit përkatës për të caktuar tarifat për personat e verbër, dhe nuk vendos kushte të tjera mbi këtë çështje.

Problematika qendron në atë çfarë është parashikuar në këtë udhëzim. Konkretisht në pikën 3, të tij, citohet që personat e verbër dhe pjesërisht të verbër përjashtohen nga tarifat postare. Kjo është shumë e drejtë dhe duhet zbatuar për rastet kur një shërbim postar kryhet nga një person që ka statusin e të verbërit. Ndërsa për çudi, jashtë çdo arsyeje logjike, në pikën 4 të udhëzimit, e drejta e përjashtimit nga tarifat postare i jepet vetëm një shoqate, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë. Kjo gjë përforcohet edhe më tepër në pikën 5, të udhëzimit, ku theksohet që në rastin e shoqatës, ajo duhet të jetë vetëm Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë. Pra, asnjë shoqatë tjetër nuk e ka të drejtën e përfitimit të shërbimit postar falas, përveç Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë.

Shoqata “Shpresë për të verbërit” është një organizatë me interesa legjitime, e njohur nga shteti shqiptar dhe e regjistruar në gjykatë. Ajo përfaqëson interesat e një grupi të caktuar të verbërisht, ashtu siç mund të jenë edhe shoqata të tjera. Në këtë kuptim, pala ankuese, si shoqatë duhet të ketë të drejta të barabarta me të gjitha organizatat e tjera të ngjashme me atë. Shoqata “Shpresë për të verbërit” është krijuar në vitin 2019 dhe rrjedhimisht njohja me këto probleme të krijuara nga disa akte ligjore dhe nënligjore është bërë brenda kësaj periudhe dy vjeçare, gjatë së cilës shoqata ka patur aktivitetin e saj.

Pala ankuese, ndihet e diskriminuar nga diferencimi që u bëhet nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, duke u trajtuar në mënyrë të ndryshme nga kjo shoqatë, duke u vendosur në pozita më pak të favorshme, dhe duke iu mohuar mbështetja (financiare) e cila i ofrohet një shoqate tjetër. Dallimi që i bëhet palës ankuese, në raport me mbështetjen që i jepet Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, nuk është i bazuar në ligj dhe nuk ka asnjë argument që ta sqarojë këtë fakt.

Pala ankuese shprehet se, të gjitha institucionet që punojnë në këtë fushë, pra të ofrimit të shërbimeve postare, duhet të bazohen vetëm në ligj. Ato duhet të ndjekin jo vetëm zbatimin e tij, por edhe të udhëhiqen nga parimet që shpreh ligji në fjalë, ashtu edhe parimet themelore të të drejtave të njeriut, duke mos diferencuar padrejtësisht persona apo grupe interesi. Nxjerrja e akteve nënligjore, zbatimi dhe kontrolli i ligjshmërisë së tyre nuk është përgjegjësi vetëm e

ministrisë përkatëse, por edhe e institucioneve dhe strukturave të tjera përgjegjëse. Në nenin 5, të ligjit nr. 46/2015 parashikohet se : *“Organet kompetente në fushën e shërbimeve postare janë ministri përgjegjës për shërbimet postare dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”*. Meqënëse tashmë nuk ekziston më Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, kompetencat e shërbimeve postare dhe në përgjithësi të kësaj fushe i ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Si rrjedhojë, është kompetencë e kësaj ministrie kontrolli i ligjshmërisë së punës së saj. Përderisa udhëzimi në fjalë është në fuqi, organi që lidhet direkt me të është MIE. Gjithashtu përgjegjësia në këtë drejtim, për kontrollim e vazhdueshëm të ligjshmërisë dhe zbatimin e ligjit është shprehur qartë në nenin 6, pika 3 e po këtij ligji ku citohet: *“Ministri përgjegjës ka këto kompetenca: ...3. Nxjerr urdhra dhe udhëzime për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të sektorit postar.”*

Sipas palës ankuese, një institucion/strukturë tjetër mjaft me rëndësi në kontrollin e ligjshmërisë dhe funksionimit të shërbimeve postare është edhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Konkretisht në nenin 7, pika 1, e ligjit nr. 46/2015, përcaktohet se : *“1. AKEP-i është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, i cili është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike.”*. Në vazhdim në nenin 9, pika 2 parashikohet se: (AKEP) *“Mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të tij, dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij.”* Ndërsa më qartësisht shprehet në nenin 29, pika 1 e ligjit: *“1. AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave, nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave për shërbimet universale postare, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal postar, kur konstaton se ato nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.”*

Sipas palës ankuese, institucioni apo subjekti i tretë që ka përgjegjësi direkte për çështjen e trajtimit të diferencuar përsa i takon pagesave të shërbimeve postare është vetë Posta Shqiptare sh.a, pasi është subjekti që aplikon direkt këtë diferencim në pagesë.

Rëndësia e trajtimit të barabartë, të drejtë dhe jo diskriminues shprehet pikërisht edhe në ligjin nr. 46/2015 *“Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 2, pika 6, duke vazhduar më pas në nenin 4, pika 1.

Pala ankuese parashtron se, një vëmendje të veçantë mbrojtjes nga diskriminimi i ka dhënë miratimi i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, duke shprehur që në nenin 1 të tij, rëndësinë e zbatimit të parimit të barazisë, madje duke cituar konkretisht edhe shkakun e aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Sipas palës ankuese, faktet e parashtruara më sipër, përbëjnë diskriminim, siç përkufizohet në nenin 3, të ligjit nr. 10221/ 2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* ku me diskriminim kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, të Shoqatës Shpresë për të Verbërit, në krahasim me SHVSH.

Pala ankuese parashtroi se, institucionet e lartpërmendura nuk kanë marrë asnjë masë, për të ndaluar këto padrejtësi dhe diferencim që i bëhet jo vetëm asaj, por edhe shoqatave tjera, në lidhje me pagesën e tarifave postare. Institucionet shtetërore përkatëse kanë detyrimin ligjor të vepronë për ndalimin e mohimit të barazisë dhe mosveprimi i tyre, me apo pa qëllim, me apo pa vetëdije, është diskriminim. Kjo shprehet shumë qartë në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Gjithashtu në neni 20, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, theksohet se është i ndaluar diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve, duke e detajuar në pikën 2, germa “c”, ku përmenden edhe avantazhet sociale dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar. Përderisa një institucion ia ofron këto avantazhe një grupi personash/organizate të ngjashme me shoqatën tonë dhe ky shërbim mohohet ndaj nesh, ky veprim përbën pabarazi në dhënien e shërbimit (pa pagesë). Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situatë të ndryshme trajtohen njësoj.

Në përfundim pala ankuese, kërkon konstatimin e diskriminimit që i bëhet asaj dhe personave të verbër, për shkak të aftësive të kufizuara si dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga institucionet e mësipërme. Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, marrjen e masave të mëposhtme:

- Konstatimin e diskriminimit të Shoqatës “Shpresë për të Verbërit” nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Posta Shqiptare sh.a.
- Detyrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për kryerjen e rregullimeve të duhura në pikat 4 dhe 5, të udhëzimit nr. 4038, datë 04.09.2015 “*Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër*”.
- Detyrimin e AKEP dhe Postës Shqiptare sh.a, të përfshijnë sa më parë edhe shoqatën tonë (dhe të tjera) si organizata në mbrojtje të të verbërve në listën e organizatave që përfitojnë shërbimet postare falas.
- Të detyrojë Postën Shqiptare sh.a të zbatojë udhëzimin nr.4038, për çdo të verbër që kërkon t’i ofrohet ky shërbim.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr.6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër. Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, si person juridik, pasi trajtohet në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, duke mos përfituar shërbimet universale postare pa pagesë, të cilat referuar udhëzimit nr. 4038, datë 04.09.2015 “*Për përcaktimin e shërbimeve universal*

postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër” përfitohen vetëm nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë. Pala ankuese pretendon se është diskriminuar dhe i është cënuar e drejta për barazi, për sa kohë që avantazhet që i ofrohen një grupi personash/organizate të ngjashme me palën ankuese, i mohohet kësaj të fundit edhe pse ndodhen në situata të ngjashme.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet : “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.....”

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet : “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, pasi

rezulton se të drejtat dhe interesat legjitime të palës ankuese çënohen nga udhëzimi nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”.

Shkaqet e pretenduara nga ankuesi *aftësia e kufizuar dhe përkatësia në grup të veçantë*, janë shkaqe të mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohen se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se : “2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”

Sa më sipër ankesa objekt shqyrtimi hyn në kompetencat e Komisionerit, e për rrjedhojë u mor në shqyrtim nga ana e tij.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.110 prot., datë 15.01.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga MIE, AKEP dhe Posta Shqiptare sh.a, në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është drejtuar ankesa.
2. Me shkresën nr.659/1 prot., datë 25.01.2021, MIE ktheu përgjigje, në lidhje me ankesën, duke parashtruar se:
 - Udhëzimi nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, është miratuar në vitin 2015 dhe referenca në pikën 4, të këtij udhëzimi për përjashtimin nga tarifat postare edhe të Shoqatës të të verbërve në Shqipëri, me sa kuptojmë duhet t’i jetë referuar faktit se në atë periudhë kjo shoqatë përfaqësonte zyrtarisht personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në Shqipëri.
 - MIE, në hartimin e politikave dhe akteve ligjore e nënligjore sektoriale, respekton kërkesat ligjore për mosdiskriminimin, të cilat janë të shprehura qartë dhe në nenin 4, të ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë.
 - MIE në bashkëpunim me AKEP do ndërmarrë ndryshimin e udhëzimit nr.4038, datë 04.09.2015, me qëllim adresimin e problemit të ngritur.
3. Bazuar në nenin 33/9, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se : “9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa. ”.

Bazuar në këtë kompetencë ligjore, si dhe duke vlerësuar gadishmërinë e treguar nga MIE, për të ndërmarrë rregullimet e nevojshme dhe ndryshimin e udhëzimit nr.4038, datë 04.09.2015, Komisioneri me shkresën nr. 372/2 prot., datë 24.02.2021, kërkoi nga MIE, marrjen e masave për rregullimin të situatës gjatë kohës që ankesa është duke u shqyrtuar pranë Komisionerit, përmes ndryshimit të udhëzimit të mësipërm në mënyrë që përjashtimi nga pagesat për dërgesat postare të aplikohet të mënyrë të njëjtë për të gjitha organizatat që mbrojnë të drejtat dhe interesat e personave të verbër dhe pjesërisht të verbër.

4. AKEP dhe Posta Shqiptare sh.a nuk kthyen përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion. Në këto kushte Komisioneri, me shkresën nr. 372 prot., datë 24.02.2021 dhe nr. 372/1 prot., datë 24.02.2021, kërkoi në mënyrë të përsëritur nga AKEP dhe Posta Shqiptare sh.a, që të parashtronin qendrimin e tyre në lidhje me çështjet e parashtruara në ankesë dhe të dërgonin informacionin e kërkuar.
5. Me shkresën nr. 431/1 prot., datë 04.03.2021, Posta Shqiptare sh.a ktheu përgjigje, duke parashtruar se:
 - Posta Shqiptare sh.a, pas komunikimeve verbale dhe shkresore me MIE, si institucion politikbërës, shprehu dakortësinë për projekt-aktin e hartuar prej saj “Për një shtesë dhe një ndryshim në udhëzimin nr.4038, datë 04.09.2015 *“Për përcaktimin e shërbimeve universal postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”*, i cili është ende në proces.
 - Posta Shqiptare sh.a, zbaton legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për ofrimin e shërbimeve postare për personat e verbër dhe çdo post pune është i pajisur me udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015.
6. Me shkresën nr. 78/3 prot., datë 09.03.2021, AKEP ktheu përgjigje, duke parashtruar se:
 - Me qëllim adresimin e problemit të ngritur, siç është cituar në shkresën nr.659/1 prot., datë 25.01.2021, të MIE, kjo ministri në bashkëpunim me AKEP, ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin e udhëzimit nr.4038, datë 04.09.2015. Me shkresën nr.186/1 prot., datë 05.02.2021, AKEP ka paraqitur kontributin e tij në ndryshimin e udhëzimit të sipërcituar dhe ia ka përcjellë MIE-s.
7. Me shkresën nr.659/4 prot., datë 23.03.2021, MIE , informoi Komisionerin, se:
 - Pas një procesi konsultimi me AKEP, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Postën Shqiptare sh.a, u miratua Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1, datë 26.02.2021 *“Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”*.

Refruar faqes zyrtare në internet, të Qendrës së Botimeve Zyrtare (www.gov.al), rezulton se Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1, datë 26.02.2021 *“Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”*, është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr.39, datë 12.03.2021, faqe 4816. Në këtë udhëzim, parashikohet si vijon: *“1. Kudo në përmbajtje, emërtimi:”Shoqata/ën e të verbërve në Shqipëri”, të zëvendësohet me fjalët “...Shoqatat apo organizatat e regjistruara për të verbërit në Shqipëri...”. 2. Pas pikës 9, të shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje: “9/1. Përfaqësuesi i Shoqatës apo organizatës për të verbërit, përfutuese e shërbimeve universal postare pa pagesë sipas këtij udhëzimi, paraqet në sportelin postar kopje të dokumentit të regjistrimit në*

gjykatë”. 3. Ngarkohet Ofruesi i shërbimit universal postar dhe AKEP për zbatimin e këtij Udhëzimi. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.”

Rezulton se, ndryshimi që i është bërë udhëzimit nr.4038, datë 04.09.2015, eliminon diferencën në trajtim, midis palës ankuese si shoqatë përfaqësuese e të drejtave të personave të verbër ose shoqatave të tjera të ngjashme me të, dhe Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, e cila bazuar në udhëzimin e mëparshëm ishte e vetmja shoqatë që përfitonte përjashtimin nga pagesa për shërbimet universale postare. Me miratimin e udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1, datë 26.02.2021, pala ankuese përfshihet si kategori që përfiton nga përjashtimi i pagesës për shërbimet universale postare.

Rezulton se qëllimi për të cilin ka filluar procedura administrative objekt shqyrtimi, e filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga pala ankuese, është pikërisht eliminimi i diferencës në trajtim, që realizohej nëpërmjet përjashtimit që i bëhej palës ankuese, por edhe shoqatave të tjera të ngjashme, të cilat nuk përfitonin nga përjashtimi në pagesat për shërbimet universale postare, avantash ose mundësi kjo që ofrohej për Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë. Rezulton gjithashtu se, objekt i ankesës së paraqitur nga pala ankuese, pra veprimi ose masa konkrete që kërkohet të ndërmerret për përmbushjen e këtij qëllimi është ndryshimi i udhëzimit nr.4038, datë 04.09.2015 me qëllim kryerjen e rregullimeve të nevojshme.

Përgjigjja e dërguar nga MIE në lidhje me miratimin e udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1, datë 26.02.2021 *“Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”*, i’u komunikua palës ankuese, e cila me email-in e dërguar në adresën zyrtare të Komisionerit info@kmd.al, në datë 01.04.2021, ka deklaruar se është dakort me rregullimet përkatëse të ndërmarra nga MIE. Për të shmangur problemet në zbatim, pala ankuese kërkon që udhëzimi t’u komunikohet të gjitha filialeve të postës.

Ndryshimi i situatës ligjore, nëpërmjet miratimit të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 26.02.2021 *“Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”*, rezulton të ketë sjellë përmbushjen e qëllimit për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese. Si pasojë e ndryshimit të situatës ligjore edhe objekti i ankesës, pra detyrimi i MIE-s për të ndryshuar udhëzimin nr.4038, datë 04.09.2015 është përmbushur nga ana e këtij subjekti.

Komisioneri vlerëson bashkëpunimin dhe angazhimin nga ana e MIE-s për rregullimin e menjehershëm të situatës, si dhe bashkëpunimin dhe ndërveprimin në një kohë të shpejtë të gjithë autoriteteve të përfshira.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 162 regjistri, datë 30.12.2020, të paraqitur nga pala ankuese Shoqata “Shpresë për të

Verbërit” kundër MIE, AKEP dhe Postës Shqiptare sh.a, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pikat 9 e 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.162 Regjistri, datë 30.10.2020, paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit” kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Postës Shqiptare sh.a, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Rekomandohet Posta Shqiptare sh.a dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si institucione përgjegjëse për zbatimin e Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 26.02.2021 “Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, që të realizojnë komunikimin dhe njoftimin e këtij udhëzimi, në çdo filial të Postës Shqiptare sh.a ose vend ku ofrohen shërbimet universale postare.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku i diskriminimit: Aftësia e kufizuar, përkatësia në grup të veçantë
Fusha: Shërbime
Lloji i diskriminimit: Ndërprerje e procedurës /Arritje qëllimi